

LOJËRAT DRAMATIKE TË XHAMLLIT NË TREVËN E STRUGËS

BEXHET ASANI

Zagraçan, Strugë, Maqedoni,

Email: b.asani@live.com

Në rajonin e Strugës janë zhvilluar të gjitha llojet e folklorit, krahas tyre është zhvilluar edhe figura e xhamallit, e cila gjer më sot nuk ka qenë e hulumtuar jo vetëm në trevën e Strugës por edhe më gjerë ndër ne. Xhamalli, nga banorët e trevës së Strugës është i njohur me emrat: lugat, gogol, xhamball dhe gogoloç. Çdo fshat apo vendbanim pothuaj ka pasur lugatin apo gogolin e vet. Zakonisht Xhamalli ishte një burrë i fortë e shtathedhur, ndërsa “nusja e xhamallit” mund të ishte cilido mashkull pa marrë parasysh konstruktin e trupit. Pas Luftës së Dytë Botërore, deri në vitet e gjashtëdhjeta xhamallë më në zë kanë qenë: Sadulla Iljazi e Maksut Lumani në Frëngovë, Ramiz Mamudi Alil Demishai në Zagraçan, Emin (Min) Yska, Rushan Malo në Ladorisht etj. Kurse rolin e “nuses së xhamallit” e luanin këta persona: Tosum Murati, Iljaz Memeti, Veiz Shaolli, Subi Baftiari, Qemal Bajrami, Gani Malo, Mersin Murati etj. Më vonë zanatin e tyre rrallë kush e ushtroi sepse nuk ishte dhe aq lehtë për ta ushtrua këtë zanat. Jo vetëm se roli i xhamallit ka qenë i vështirë për t’u luajtur por ky zanat sa vinte e bëhej gjithnjë e më i zbehur e po lihej në harresë. Shkaqet të cilat ndikuan që figura e xhamallit të zhdukej do t’i shohim më poshtë. Figura e xhamallit, sot jeton vetëm në kujtesën e bashkëkohësve të tij.

Xhamalli apo lugati ose xhamballi ka qenë i pranishëm në dasmën e vogël (syneti) dhe dasmën e madhe (martesa). Ai, gogoloçi maskohet në këtë mënyrë: vesh gunë të vjetër, herë-herë edhe të grisur, përvesh krahët gjer në bërryl, pantallona të përveshura apo të grisura gjer te gjunjët etj. Në kokë vinte sheshir i cili vende-vende ishte i grisur, ndërsa në fytyrë nxihej me thëngjill, vinte mustaqe dhe mjekër, ndërsa mbi gunë varte zinxhirë, katarinë (dry) e këmborë të llojeve të ndryshme, kurorë me qepë e vargje me specatë thata. Mbante bastun dhe shpatë. Edhe pse në të kaluarën dasmat, kryesisht bëheshin gjatë stinës së vjeshtës dhe stinës së dimrit, kur temperaturat ishin mjaft të ulëta, xhamalli në shi e në dëborë ecte këmbëzbathur. Gjatë shetitjes së synetliut nëpër rrugicat e fshatit, si dhe nga

momenti i nisjes së krushqve për ta marrë nusen në fshat ose te ndonjë fshat fqinj apo për ta shëtitur synetliun, tërë kohën lugati do të bëjë lojëra të ndryshme. U lëshohet fëmijëve t’i trembë, trembë ndonjë kalimtar të rastit që takon gjatë rrugës, i turret dhe i matet “t’i bie” me shpatë! Dasmorët dëshmitarë thonë se ndonjërit udhëtar ose edhe ndonjë dasmori i binte të fikët. Atij që i binte të pakët, krushqit i kthenin vetëdijen duke e lagur me ujë dhe duke i rënë fytyrës me shuplaka. Si duket disa sjellje të gogolit kanë qenë të rrezikshme për jetën e njeriut.

Kur dikush nga krushqit do të vallëzonte ose do t’ia “merrte nusen” lugatit, ai, atëherë egërsohej, kështu lojërat do të bëheshin më tërheqëse dhe tepër interesante sepse gogoloçi do ta sulmonte atë krushk, atë dasmor i cili ia kishte “marrë nusen”, “dashnorin e nuses së tij” e rrëzonte në baltë apo në dëborë kudo që ta zinte duke e ndjekur. Ndërsa “nusja”, xhamballit e cila vazhdimisht luan valle dhe i përfaqon krushqit, në dorë mban një gjilpëryer me qëllim që t’i shpojë, apo pickojë burrat “të dashurit e saj”. “Partnerja” e xhamallit është një burrë i veshur me teshat më të reja të nuseve si shihet edhe te fotografia nr. 1. Këtë veshje ia kompletojnë gratë, të cilat e mësojnë edhe se si të vishet. Rrugës krushqit ecin në radhë, zakonisht dy nga dy. Këtë rregull, këtë zakon nuk e zbaton asnjëherë, xhamalli mashkull dhe partnerja e tij. Xhamalli është i lirë, të ecë nga t’i kujtohet: drejtë, djathtas, majtas, para, pas, parapëlqen të ecë nëpër hendeqe dhe vija, duke u rrëzuar e zhgëryer për toke. Të tëra këto lojëra bëhen me qëllim që t’ua tërheqë vëmendjen njerëzve dhe të largojë syrin e keq nga synetliu apo nga nusja dhe dhëndri.



Izet Demishai në valle me “nusen” e xhamallit dhe me xhamallin. Foto nr.1. e vitit 1964

Xhamalli, me lojërat e tij dramatike, është i pranishëm deri në mesnatë, por, ndodh herë-herë që të jetë i pranishëm edhe deri në agim, deri atëherë kur edhe zgjohet dhëndri me nusen. Lugati, siç pohojnë informatorët, shpesh herë e ka marrë viçin në kurriz dhe e ka çuar në dhomë që ta therë. Në qoftë se dasmori ishte i varfër gogoli e lëshonte viçin, por, po të qëllonte dasmori me një gjendje relativisht të mirë ekonomike, ai e therte viçin, e do të hanin meze për tërë natën. Informatorët, dëshmitarë okularë thonë, se Ramiz Mamudi nga fshati Zagraçan i trevës së Strugës, gomarin e ka marrë në kurriz dhe e ka ngjitur në katin e dytë të shtëpisë, e ka çuar te dhoma e miqve. Gomarin e ka shtrirë në dhomë, ndërsa ai pëlliste, ai i jepte raki të pijë, ndërkohë lodrat dhe pizgat binin, bënin muzikë, gjer në mëngjes gomari ka plasur. E tëra kjo bëhej për t’i argëtuar miqtë sa më mirë që të mos mërzhiteshin gjatë natës. Të pranishmit mblidhnin para dhe i blinin të zotit një gomar tjetër.

Xhamalli ose gogoli apo lugati alias gogoloçi, është i pranishëm edhe te gratë gjatë ceremonisë së dasmës, njëlloj si xhamalli te burrat. Po, lojërat dramatike te femrat janë më të buta, nuk janë aq agresive si lojërat e xhamallit te burrat. Përderisa xhamalli te burrat lojërat e tij dramatike do t’i zhvillonte kryesisht jashtë në natyrë dhe më pak në shtëpi, qoftë te shtëpi e synetliut, qoftë te shtëpi e dhëndrit ose te shtëpi e nuses.

Gratë të cilat e ushtronin zanatin e xhamallit, e që dalloheshin për nga lojërat e tyre të mrekullueshme, ishin këto: Rakibe Bajrami, Reshida Memeti, Xhezie Dauti, Eftushe (Tushe) Selmani etj. Duhet theksuar se çdo fshat ka pasur xhamallët e tij, si te burrat ashtu edhe te gratë. Lugati femër vishet si mashkull, me xhoke ose setre, me pantallona, në kokë vë kapë, vë mustaqe dhe mjekër. Në dorë mban baston, kurse në vend të penisit te pantollonat e vë gurmazin e lopës

ose të kaut, që është ther për dasmë. Gjysmën e gurmazit do ta lërë përjashta të varur me qëllim që të imitojë penisin. Gratë do të gajasen së qeshuri. Disa nga gratë turpërohen dhe fshihen kur e shohin të veshur në këtë dorë dite. Kurse gratë e tjera pasi ta shihnin me “penis” të nxjerrë, e duke e mbajtur me dorë, do të merrnin guxim dhe do ta kapnin, e do ta shtrinin për toke. Pasi ta shtrinin për toke, xhamallin do ta bënin “synet”. Ndërsa lugati do të bërtasë e do të bëjë sikur qan gjatë momentit të “rrethprerjes”, sepse i “dhemb”. Pasi të “bëhet synet”, gogoli do të vazhdojë me lojërat e tij, duke i përqafuar dhe duke i puthur nuset e reja.

Xhamalli ka edhe “partneren” e tij, të cilën, gartë përpiqen që ta fshehin, atëherë, xhamalli do të “egërsohet”, kështu, tani lojërat do të bëhen më interesante dhe tepër dramatikë. Kulmi i lojërave të xhamallit te femrat do të arrijë kur xhamalli me nusen e tij, me partneren e tij, apo me ndonjë nuse tjetër, e cila është e pranishme në dhomë, do të kryejë apo do të imitojë aktin seksual. Këto akte të “marrëdhënieve seksuale”, që i bën xhamalli nuk janë asgjë tjetër, përveç asaj që ndjellin pjellori, te çifti i sapo martuar, me qëllim që të shtohet familja, me anëtarë të rinj. Lojëra të tilla të ngjashme do të vazhdojnë deri vonë në mesnatë e herë-herë deri kur të zgjohet në mëngjes dhëndri dhe nusja.



Xhamalli hedh valle me “partneren”. Foto e vitit 1972.

Duhet theksuar se mënyra tradicionale e marrjes së nuses me kalë apo me qerre qesh ose e shëtitjes së synetliut me kalë ose me qerre, është zhdukur fare. Nusja sot merret me veturë, ndërsa synetliu nuk shëtit me krushqit nëpër fshat. Kështu që xhamallit nuk i jepet mundësi, kohë dhe hapësirë për të vepruar, sepse ai nuk ka mundësi të ecë apo të vrapojë barabartë me shpejtësinë e veturës, e cila shkon me dhjeta kilometër në orë.

Qytetërimi në një rën anë dhe mënyra e jetesës në anën tjetër, ka bërë që xhamalli dhe lojërat e tij të shumta të zhduken pothuajse gradualisht. Gjurmë të xhamallit, sot ruhen shumë rrallë, figura e xhamallit, mund të ruhet vetëm te gratë. Por vlen të theksohet se lojërat e tij janë tepër të zbehta. Në rajonin e Strugës, pleqtë dhe plakat, shpesh herë, gogolin apo xhamballin e kohëve më të hershme e përmendin me nostalgji. Xhamalli i fundit Alil Demishai i cili është ende gjallë, ka qenë në dasmën e Islam Comës nga fshati Shum në vitin 1974. Kjo dasmë njëherit ka qenë edhe dasma e fundit, në të cilën dasmë nusja është marrë me qerre kali të mbuluar me qilima. Por kohët e fundit sikur njerëzit po i rikthehen traditës, kanë filluar që disa nuse të merren me qerre kali apo me pajton. Mbase një ditë do të rikthehet edhe xhamalli me lojërat e tij dramatike të mrekullueshme.
